



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.1, datë 26/02/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES NR.SERIE 00004, MIRATUAR NGA KBU MAT ME VENDIMIN NR.34, DATË 22.02.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, SUBJEKTIT “LEZHA KONSTRUKSION” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare me Nr.serie:00004, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.34, datë 22.02.2017, subjektit “Lezha Konstruksion” sh.p.k, me vendndodhje, Njësia Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- $X= 471220.5$; $Y= 4621971.6$; $Z=1$ m.m.n.d;

- Prurja mesatare : $Q_{mes}= 2$ l/s

- Sasia e ujit në përdorim : $Q= 0.3$ l/s

- Qëllimi i përdorimit : Sanitar (Shitje materjale ndërtimi)

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top and "KESHILI I BASENIT UJOR" at the bottom. In the center, there is a shield with an eagle, and the word "MAT" is printed below it.